

FUNKSIONI 7: SHËNDETËSIA

Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor

Përmbajtja

HYRJE	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 07220	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT	5
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	7
4. TË DHËNA MBIPROGRAMIN	9
5. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2023-2025	10

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 07220

Vështrim i përgjithshëm		
Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor;		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	<ul style="list-style-type: none">Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Ky program është një ndër funksionet e Bashkisë së Shkodrës. Me qëllim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përgjatë të gjithë vitit organizohen aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, si dhe merren masa për projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimin e infrastrukturës së ndërtuar.

Për vitin 2023 në Programin “Shërbimet e kujdesit parësor”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 2 aktivitete:

- **P07220.O1.A1** Informimi dhe Promovimi për një komunitet më të shëndetshëm.
- **P07220.O1.A2** Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor.

Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Pjesë e këtij database, i cili është në përditësim të vazhdueshëm, është projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor. Janë realizuar një sërë ndërhyrjesh në infrastrukturë, me projektimin dhe rikonstruksionin e disa objekteve, të braktisura prej vitësh, por në pronësi të Bashkisë Shkodër, duke krijuar disa qendra të reja shëndetësore si: në lagjen Nr.3, pranë njësisë administrative Rrethina (Shtoj i Vjetër), në qendrën Komunitare Multifunkionale “Ngjyrat” në lagjen nr 1, në objektin ish Hotel Sporti në lagjen nr 4 dhe në ish godinën e U.K Shkodër, në lagjen Nr.3. Janë rikonstruktuar qendra shëndetësore Trush, Bërdicë e Madhe, Velipojë dhe Zogaj. Aktualisht është në proces përfundimi rikonstruksioni i godinës së ish shkollës veterinare, në të cilën do të sigurohen ambjentet edhe për funksionimin e një qendre të re shëndetësore për lagjen Nr.1.

Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka organizuar një sërë takimesh/ sesionesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit.

Si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID- 19 dhe në bazë të protokolleve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale aktivitetet e parashikuara gjatë kësaj periudhe janë realizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe protokolleve përkatëse për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Sfidat:

Sigurimi i financimit të nevojshëm për mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionin e qendrave shëndetësore.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2023-2025								
Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia Shkoder		Institucioni-						
Programi		7220 Shërbimet e kujdesit parësor						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	0	0	0	0	0	0	0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	0	0	0	0	0	0	0
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	1,147	0	6,000	5,850	2,000	0	0
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI		1,147	0	6,000	5,850	2,000	0	0

Komente

Programi 7220: Shërbimet e kujdesit parësor ka si burim financimi te ardhurat e tjera. Shpenzimet korente zene 100% per vitin 2023.

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2.Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm	2023-2025				
Programi	07220	Shërbimet e kujdesit parësor			
Përshkrimi i Programit	Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;				
1	Qëllimi i Politikës së Programit	Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i Temave të zhvilluara. (trendi në %)	-38%	0%	0%	0%
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin. (trendi në %)	-19%	0%	0%	0%
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i pjesëmarrësve në takime e aktivitete. (trendi në %)	21%	0%	0%	0%

	Rritja e mbulimit me shërbimin e kontrollit mjekësor bazë pa pagesë (shërbimi i qendrave të kujdesit parësor) Numri i personave të shërbyer kundrejt numrit total të popullsisë së bashkisë (raporti në %)	86%	86%	86%	86%
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i Temave të zhvilluara. (trendi në %)	-38%	0%	0%	0%
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin. (trendi në %)	-19%	0%	0%	0%
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit : Numri i pjesëmarrësve në takime e aktivitete. (trendi në %)	21%	0%	0%	0%
	Përmirësimi i informimit dhe edukimit shëndetësor të komunitetit ; Numri i pjesëmarrësve në takime e aktivitete vajza/gra. (trendi në %)	10%	0%	0%	0%
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Numri i qendrave shëndetësore funksionale.	14	14	14	14
	Numri i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura	2	1	0	0
	Numri i qendrave shëndetësore të ndërtuara (të reja) dhe të rikonstruara;	1	0	0	0
	Rritja e mbulimit me shërbimin e kontrollit mjekësor bazë pa pagesë (shërbimi i qendrave të kujdesit parësor) Numri i personave të shërbyer kundrejt numrit total të popullsisë së bashkisë (raporti në %)	86%	86%	86%	86%
Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT				
Programi Buxhetor Afatmesëm		2023-2025		
Programi	7220	Shërbimet e kujdesit parësor		
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.		
1.1.A.	Produkti	Aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P07220.Q1.O1.A1		
	Përshkrimi i Produktit:	Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve.		
	Njësia Matëse	Numër aktiviteteve		
		2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani
	Sasia	60	60	60
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		#DIV/0!	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i koston për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.		
1.2.A.	Produkti	Numri i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P07220.Q1.O2.A1		
	Përshkrimi i Produktit:	Mirëmbajtja e qendrave shëndetësore parësore		
	Njësia Matëse	Numri i qendrave të mirëmbajtura		
		2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani
	Sasia	2	1	0
	Kosto totale (në mijë lekë)	3,000	2,000	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	1,500.0	2,000.0	#DIV/0!

Ndryshimi në % i Sasisë		-50.0%	-100.0%	#DIV/0!
Ndryshimi në % i kostos totale		-33.3%	-100.0%	#DIV/0!
Ndryshimi në % i kostos për njësi		33.3%	#DIV/0!	#DIV/0!

Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

4. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 4. Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin									
Programi 7220	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të dhënat e programit/ Vitet									
Numri i temave		13	20	20	32	20	20	20	20
Numri i aktiviteteve		54	51	44	74	60	60	60	60
Numri i pjesëmarrësve		1,110	1,026	391	988	1,200	1,200	1,200	1,200
Numri i pjesëmarrësve vajza/gra		800	785	230	730	800	800	800	800
Numri i qendrave shëndetësore funksionale.		14	14	14	14	14	14	14	14
<i>Njësia qendër</i>		4	4	4	4	4	4	4	4
<i>Njësitë administrative</i>		10	10	10	10	10	10	10	10
Numri i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura		0	1	0	1	2	1	0	0
Numri i qendrave shëndetësore (të reja) dhe të rikonstruara		3	3	0	0	1	0	0	0
Numri i personave të shërbyer në qendrat e shërbimit parësor		173,029	173,029	180,643	181,628	181,628	181,628	181,628	181,628
Popullsia Totale		206,101	208,618	209,542	209,414	210,182	210,182	210,182	210,182
Shpenzime të bashkisë për shërbimin mjekësor parësor /bazë në mijë Lekë		0	0	1,147	0	3,000	2,000	0	0

5. Projektet e planifikuara për PBA 2023-2025

Tabela 5 Emërtimet e aktiviteve

Projekte të planifikuara				000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Institucioni Likuidues	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025
P07220.Q1.O1.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm	Bashkia Shkodër	-		
P07220.Q1.O2.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor	Bashkia Shkodër	2,000		
Totali		2,000	-	-

Nr. 1	P07220.Q1.01.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm	Funksioni 7 : SHËNDETËSIA N/Funksioni 072: Shërbimet e kujdesit parësor Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik gjatë vitit 2022 ka organizuar një sërë takimesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës së komunitetit. Këto takime janë organizuar pranë qendrave komunitare "Për Familjen" dhe në shkollat 9 vjeçare e të mesme të Bashkisë së Shkodrës. Temat e referuara gjatë këtyre takimeve janë në përputhje me kalendarin kombëtar të shëndetit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Organizimi dhe zhvillimi i këtyre aktivitetëve është realizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor dhe atij arsimor me moton "Së bashku për shëndetin tuaj". Takimet janë organizuar në qendrat komunitare "Për Familjen", në qendrën rinore "Atelie", në shkolla, në zonën urbane dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Postribë, Ana e Malit, Rrethina dhe Bërdicë.</p> <p>Gjatë vitit 2022, Bashkia Shkodër ka vazhduar informimin, sensibilizimin e opinionit publik, ndërgjegjësimin dhe apelin për bashkëpunim nga ana e qytetarëve për respektimin e rregullave të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Instituti i Shëndetit Publik, rritjen e masave higjieno- sanitare dhe shmangien e panikut në mënyrë që të frenohet përhapja e COVID- 19, përmes mediave të komunikimit, mediave sociale zyrtare të Bashkisë Shkodër, posterave, afishimeve dhe fletëpalosjeve të vendosura në vende të dukshme, Zyrat me një Ndalesë etj.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Të promovojë dhe informojë komunitetin për një jetë të shëndetshme në bashkëpunim të ngushtë me qendrat komunitare "Për Familjen", qendrat shëndetësore të shërbimit shëndetësor parësor, shkollat, OJF, etj. • Të organizojë aktivitete periodike me tema të ndryshme, me synim përmirësimin e shëndetit, cilësinë e jetës dhe parandalimin e sëmundjeve në komunitet. • Të promovojë zgjerimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor parësor me qëllim mbulimin sa më të madh të popullsisë dhe territorit. • Të nxisë dhe mbështesë përfaqshen multi- sektoriale në zhvillimin e shëndetit komunitar, bashkë me sektorin social, arsimor, sportiv, etj. • Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për të organizuar aktivitetet e saj, si: NJVKSH, DRFSDKSH dhe qendrat shëndetësore përkatëse. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përgatisë prezantime dhe materiale promovuese për shëndetin bazuar në ditët ndërkombëtare, si psh. kanceri i qafës së mitrës, kanceri, higjiena e gojës dhe shëndeti oral, aktiviteti fizik tek fëmijët, autizmi, duhani, drogat, shëndeti riprodhues dhe seksual, kanceri i gjirit, dhuna, moshimi, planifikimi familjar dhe metodat kontraceptive, obeziteti, larja e duarve, COVID- 19 dhe mënyrat e mbrojtjes etj. ▪ Organizimi i së paku 12 temave (nga 1 temë/muaj) dhe organizimi i aktiviteteve promovuese dhe edukuese në komunitet. ▪ Organizimi i së paku 50 takimeve informuese dhe sensibilizuese në vit me tema të ndryshme. ▪ Organizimi i tryezave të rrumbullakëta në komunitet dhe media me synim promovimin e jetës së shëndetshme. ▪ Bashkëpunimi i afërt me OJF, organizata dhe biznesin privat në projekte që synojnë përmirësimin e shëndetit komunitar dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> ○ Komuniteti më i informuar dhe më aktiv në mbrojtje të shëndetit. ○ Qendrat komunitare "Për Familjen" pjesë aktive në koordinimin e aktivitete promovuese të shëndetit në bashkëpunim të afërt me qendrat shëndetësore dhe shkollat pranë komunitetit. 							
c) Aktorët e mundshëm.			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Komuniteti, Mjekë dhe infermierë të shërbimit shëndetësor parësor, Mësues dhe nxënës të shkollave, Personeli i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, OJF.			OJF, OSHKSH NJVKSH, DRFSDKSH, ZVA.				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1							

	Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	
A.1							
	Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	
A.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Specialist i Shëndetit Publik, Stafi i qendrave komunitare, Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 2	P07220.Q1.O2.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor	Funksioni 7 : SHËNDETËSIA N/Funksioni 072: Shërbimet e kujdesit parësor Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, ku pjesë e kësaj është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Në këtë kuadër, Bashkia e Shkodrës ka përditësuar sistemin databazë për regjistrimin e çdo qendre shëndetësore në territorin e saj me të gjitha të dhënat specifike të tyre; nevojat, shërbimet, stafin, zonën që mbulon, problematikën, funksionalitetin e qendrave shëndetësore parësore etj.</p> <p>Është vazhduar me projektimin dhe rikonstrukcionin e disa objekteve, të braktisura prej vitesh, por në pronësi të Bashkisë Shkodër, duke krijuar 4 qendra të reja shëndetësore; si në njësinë administrative Rrethina (Shtoj i Vjetër), në bashkëpunim me organizatën Eorld Vision, në qendrën Komunitare Multifunksionale "Ngjyrat" në lagjen nr 1, në objektin ish Hotel Sporti në lagjen nr. 4 dhe në ish godinën e U.K Shkodër, në lagjen Nr.3. Me fondet e Bashkisë Shkodër është rikonstruktuar qendra shëndetësore Trush. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes janë lehtësuar procedurat për rikonstrukcionin e qendrave shëndetësore Bërdicë e Madhe, Velipojë dhe ambulanca Zogaj.</p> <p>Është arritur sigurimi i financimit të projektit të qendrës komunitare Multifunksionale, në objektin ish shkolla Veterinare, në të cilin është projektuar dhe kanë përfunduar tashmë punimet për një qendër shëndetësore shumë e domosdoshme për lagjen nr 1, e cila shumë shpejt do të vendoset në funksion. Është në proces ndërhyrja për vendosjen në funksion dhe mirëmbajtjen e ambulancave Mali Kolaj dhe Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, si dhe po punohet për vendosjen dhe rehabilitimin e ambienteve të ish shkollës së Samrishtit për ndërtimin e një qendre shëndetësore për zonën përreth.</p> <p>Nga vlerësimi dhe analiza e gjendjes aktuale të infrastrukturës ekzistuese të qendrave shëndetësore parësore dhe dëgjesa publike të realizuara në kuadër të PBA 2023-2025 konstatohet nevoja për planifikimin e disa ndërhyrjeve të nevojshme me qëllim sigurimin e kushteve të nevojshme të ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor në disa ambulanca të qytetit dhe njësitë administrative Gur i Zi, Postrinë, Rrethina.Do të ngrihet një grup pune, i cili do të realizojë vlerësimet e nevojshme dhe përcaktojë prioritetet duke përcaktuar qendrat për ndërhyrje në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Vlerësimi do të bëhet edhe në kuadër të konsultimit edhe me Operatorin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe Njësinë vendore të kujdesit shëndetësor Shkodër.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojë dhe analizojë gjendjen aktuale të infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor dhe të planifikojë ndërhyrjet e nevojshme. • Të vlerësojë rastet emergjente dhe të prioritzojë ndërhyrjet që gjykohen emergjente për mungesë kushtesh. • Të promovojë zgjerimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor parësor me qëllim mbulimin sa më të gjerë të popullsisë dhe territorit. • Të vlerësojë dhe promovojë aksesin e barabartë për shërbimet shëndetësore në të gjithë segmentet apo grupet e popullatës. • Të identifikojë partnerë dhe të krijojë aleanca të qëndrueshme ndërmjet institucioneve publike, donatorëve dhe OJF-ve. • Të nxisë dhe mbështesë qasjen multi- sektoriale në zhvillimin e shëndetit komunitar, bashkë me sektorin social, arsimor, sportiv, etj. • Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për të organizuar aktivitetet e saj, si me OSHKSHSH, NJVKSHSH, DRFSDKSH. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përditësimi bazë i të dhënave për qendrat shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. ▪ Projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor. ▪ Mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar. ▪ Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore në territor në varësi të nevojave të konstatuara. ▪ Rikonstrukcion i qendrave shëndetësore parësore në territor në varësi të nevojave të konstatuara. ▪ Vlerësimi dhe monitorimi periodik i ambienteve të qendrave shëndetësore të shërbimit shëndetësor parësor në 		

<p>gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës me synim prioritarizimin e ndërhyrjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Bashkëpunimi i afërt me OJF dhe biznesin privat në projekte që synojnë përmirësimin e shëndetit komunitar dhe fuqizimin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> ○ Databazë e përditësuar me informacion mbi qendrat shëndetësore të shërbimit parësor në territorin e Bashkisë së Shkodrës. ○ Forcimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor në territorin e Bashkisë Shkodër. ○ Zgjerimi i rrjetit të shërbimit shëndetësor parësor në objekte ekzistuese të Bashkisë së Shkodrës. ○ Rritje e aksesit të barabartë për shërbimet shëndetësore për të gjithë grupet e popullatës. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti,			OJF, OSHKSHSH, NJVKSH, DRFSDKSH			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore parësore	2,000			2,000	
A.2	Projektim për rikonstruksion të qendrave shëndetësore parësore					
A.3	Rikonstruksion i qendrave shëndetësore parësore					
Shuma		2,000			2,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore					
A.2	Projektim për rikonstruksion te qendrave shëndetësore parësore					
A.3	Rikonstruksion i qendrave shëndetësore parësore					
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Mirëmbajtje e qendrave shëndetësore					
A.2	Projektim për rikonstruksion te qendrave shëndetësore parësore					
A.3	Rikonstruksion i qendrave shëndetësore parësore					
Shuma						
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025		Stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Drejtorisë Juridike, Sektori i aseteve				
		Institucioni Likujdues: Bashkia Shkodër				